



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.nr.1/24

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, Kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit-propozuesit të sigurimit Fresh Boxx Shpk me adresë në Babimoc, Magjistralja Prishtinë-Mitrovicë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.S. avokat nga Prishtina, kundër kundërshtarit të sigurimit “ B No 1 SHPK të cilin sipas autorizimit e përfaqëson me seli ne Parkun Industrial Trepça Fabrika e akumlatorëve, Mitrovicë NRB 71024423, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave te shkalles e parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.716/23 datës 03.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 09.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e propozuesit të sigurimit Fresh Boxx Shpk me adresë në Babimoc, Magjistralja Prishtinë-Mitrovicë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e shkallës së parë, për Çështje Ekonomike, KE.nr.716/23 datës 03.11.2023, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor KE.nr.716/23 datës 03.11.2023, ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve të sigurimit Fresh Boxx SHPK, me të cilën kanë kërkuar që ndaj kundërshtarit të sigurimit, të caktohet masa e sigurisë, dhe ti ndalohet të paditurit B No 1 Shpk që ta tjetërsoj, ta fsheh, ta ngarkoj dhe te disponojë me pasurinë e lujtshme dhe te paluajtshme ne lartësi te kërkesëpadisë së paditësit, si dhe te detyrohet Banka Komerciale si dhe Banka Qendrore qe ndalimin ta evidentojnë ne regjistrat përkatës, deri ne përfundim te kontestit.

Kundër këtij aktvendimi kanë paraqitur ankesë e autorizuari i propozuesit të sigurimit, me te cilën, e kundërshton aktvendimin e atakuar për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit, të prishet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Ekonomik, KE.nr.716/23 datës 03.11.2023, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosije.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të

dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesat është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit Fresh Boxx SHPK, në Gjykatën Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, ka paraqitur propozim me të cilën kanë kërkuar që ndaj kundërshtarit të sigurimit dhe ti ndalohet të paditurit B No 1 Shpk që ta tjetërsoj, ta fsheh, ta ngarkoj dhe te disponojë me pasurinë e luajtshme dhe te paluajtshme ne lartësi te kërkesëpadisë së paditësit, si dhe te detyrohet Banka Komerciale si dhe Banka Qendrore qe ndalimin ta evidentojnë ne regjistrat përkatës, deri ne përfundim te kontestit

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor ka Refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve të sigurimit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhomat e shkallës së parë, thekson se ka ardhur në përfundim se propozuesit e masës nuk kanë arritur ta bëjnë të besueshme plotësimin e dy kushteve kumulative siç përcaktohet me nenin 297.1 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji gjene se, Dhoma e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së mase se sigurisë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund ti pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Në raport me këto pretendime ankimore Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë janë dhënë kushtet ligjore që duhet përmbushur për caktimin e masës së sigurimit. Rrjedhimisht propozuesi nuk ka ofruar as fakte dhe dëshmi se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye caktimi i masës të sigurisë është i domosdoshëm. Demi

konsiderohet i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyre të arsyeshme me ane të një kompensimi financiar. Në fakt propozimi në masë të sigurisë, duhet të jetë i besueshëm, ashtu që kërkesa të përfshijë mundësinë e rrezikut të menjëhershëm dhe të pariparueshëm.

Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur shkelje në dëm të palës propozuesi duke mos caktuar masën e sigurisë. Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive. Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të ankuesit në ankesë, Kolegji vlerëson se të njëjtat tërësisht janë e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë se paditësit, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin ndryshe në këtë çështje juridike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1/24 datë 09.01.2024

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari
Ramush Bardiqi